

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5653
E premte, 14 dhjetor 2018
çmimi 0.40 €

Sejdiu: Në vitin
2019 spitalet rajonale
do të jenë prioritet
kryesore IFAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS DO TA VOTOJË SOT PAKON
LIGJORE PËR TRANSFORMIMIN E FSK-SË NË USHTRI

Sot votimi historik për ushtrinë e Kosovës



Republika e Kosovës sot (e premte) zyrtarisht do të bëhet me ushtri. Të zgjedhurit e popullit do t'i votojnë tri projektligjet për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri. Votimit historik të

Kuvendit për ushtrinë e Kosovës i ka paraprirë mbështetja e fuqishme e ShBA-së. Ambasadori amerikan në Kosovë, Philip Kosnett, ka thënë se votimi për transformimin e FSK-së është historik për Kosovën.

Ndërsa presidenti Hashim Thaçi, i veshur me uniformë ushtarake, të enjten ka vizituar Kazermën "Adem Jashari", me ç'rast ka thënë se transformimi i FSK-së në ushtri është vendim i shumëpritur

FLET PËR "EPOKËN E RE", PETRIT SELIMI

Ndihma e MCC-së është ftesë për përparim të mëtutjeshëm në Kosovë

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

AKTUALE

**SHOIPTARËT
NË BALLKAN** F. 12

Ismet SYLEJMANI



**A DO TA
RRËZOJNË
STUDENTËT
EDI RAMËN?** F. 11



Nga Bedri ISLAMI

**HARADINAJ PREZANTON
DRAFTMARRËVESHJEN PËR
NORMALIZIMIN E RAPORTEVE
ME SERBINË** F. 7

**BAHTIRI I SHOETËSUAR
PËR MOSHAPJEN E URËS
MBI LUMIN IBËR** F. 11

EKONOMI

**KËRKOHEM BUXHET
PËR SHKOLLAT SHOIPE
NË DIASPORË** F. 8

**STARTON 'NJËSIA B1', KEK-U
NË PRODHIM ME KAPACITETE
TË PLOTA** F. 9

KULTURË

**PORTRET PËR PIKTOREN
E SUKSESSHME
ERLISA ÇERKINI** F. 8

SPORT

**FETAHAJ SHKËLQEU
NË VJESHË, POR
NUK E DI KU DO TË LUAJË
NË PRANVERË** F. 16

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Veseli takon kongresistin Eliot Engel

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në përmbyllje të vizitës zyrtare në ShBA ka takuar kongresistin amerikan Eliot Engel, i

cili i ka dhënë përkrahje të pazervë për ecjen përpara të shtetit të Kosovës, për transformimin e FSK-së në Ushtri dhe reformat në ekonomi e

sundim të ligjit. "Me mikun e madh të Kosovës, kongresistin Eliot Engel. Ai edhe një herë më shprehu përkrahjen e pazervë për ecjen përpara të

shtetit të Kosovës, për transformimin e FSK-së në Ushtri dhe reformat në ekonomi e sundim të ligjit", ka shkruar Veseli në faqen e tij në Facebook.



Presidenti Meta përkrah studentët, kthen Ligjin për buxhetin

Presidenti i Shqipërisë Ilir Meta ka rikthyer për shqyrtim në Parlament buxhetin e shtetit për vitin 2019, pasi vlerëson konsensusin e gjerë publik mbi kërkesat e studentëve, të cilat janë konsideruar nga të gjithë aktorët politikë si të drejta, legjitime dhe të realizueshme. I menjëhershëm ka qenë reagimi i kryeministrit Edi Rama



TIRANË, 13 DHJETOR - Për herë të parë në historinë demokratike të Shqipërisë, një president i Republikës rikthen për shqyrtim në Parlament buxhetin e shtetit. Përmes një njoftimi për shtyp, Presidenca njofton se kreu i Shtetit, Ilir Meta nuk ka dekretuar Ligjin për buxhetin e vitit 2019 dhe kjo nisur nga situata politike në vend. Në argumentimin e tij, presidenti vlerëson konsensusin e gjerë publik mbi kërkesat e studentëve, të cilat janë konsideruar nga të gjithë aktorët politikë si të drejta, legjitime dhe të realizueshme. Sipas tij, kthimi për shqyrtim i buxhetit synon interesin më të mirë në përmbushjen e objektivave sociale të parashikuara në nenin 59 të Kushtetutës, si dhe në garantimin e stabilitetit në vend. I menjëhershëm ishte reagimi i

kryeministrit Edi Rama në Twitter. "Interesant! Presidenti kthen buxhetin e Shqipërisë pas prezantimit të kërkesave të LSI-së. Asnjë çudi! Vazhdon pa pushim e në çdo formë presioni mbi studentët për të qëndruar në kor kundër dialogut. Miq! Dilni nga kurthi i atij kori dhe bëhuni individë që flasin në emër të vetes", ka shkruar Rama. Ndërkohë, më herët në Kuvend u rikthye edhe opozita pas disa muajsh bojkoti. Ajo kishte mandatuar disa deputetë për të kërkuar ndryshime ligjore në favor të studentëve. Kryetari i grupit parlamentar të LSI-së kërkoi futjen me përparësi për shqyrtim të propozimeve të bëra nga partia e tij për ndryshimin e buxhetit për plotësimin e kërkesave të studentëve. Ndërkohë, Partia Demokratike

kërkon rrezimin e krejt ligjit për arsimin e lartë. Jashtë listës së mandatuar nga opozita në Parlament u rikthye dhe deputetja e Partisë Demokratike, Rudina Hajdari, e cila përmes një postimi në Facebook thotë se nuk ka thyer ajo rregullin, ndërkohë, sipas saj, ajo thjesht kishte bërë detyrën si deputete. Pas vendimit të kreut të shtetit për të kthyer në Kuvend për rishqyrtim Buxhetin e vitit 2019 duke i dhënë mundësi qeverisë të plotësojë kërkesat e studentëve ka ardhur dhe reagimi i studentëve. Të mbledhur para Kryeministrit

atë kanë falënderuar kreun e shtetit për kthimin e ligjit. Në këtë mënyrë u hapet rruga ligjore plotësimi të kërkesave të tyre, nëse qeveria është e gatshme t'i plotësojë të gjitha ato. Studentët që po protestojnë në Tiranë, por edhe në qytetet tjera të mëdha të vendit, refuzojnë çfarëdo lloj negociate me institucionet shtetërore. Meqë këto protesta ishin spontane që nga dita e parë, studentët vazhdimisht përsëritën se nuk kanë përfaqësi. "Kërkesat i kemi të qarta, nuk kemi se çfarë të dialogojmë rreth tyre", tha një student në protestë para Kryeministrit.

"Këta duan që kërkesat e tyre të realizohen dhe pikë, dhe ne jemi këtu për t'i mbështetur", tha një qytetare që i është bashkuar protestës. Studentët protestues kanë këmbëngulur se do të vazhdojnë protestat deri në plotësimin e kërkesave të tyre. Tarifat vjetore për studentët në universitetet shtetërore të Shqipërisë, variojnë nga 25 mijë lekë (rreth 200 euro) deri në 40 mijë lekë (rreth 325 euro) në ciklin e parë të studimeve (bachelor). Ndërsa, për ciklin e dytë të studimeve, sipas profilit që ndjekin, tarifat variojnë nga 63 mijë (rreth 510 euro) deri në 204 mijë lekë (rreth 1,600 euro). Tarifat e shkollimit në universitetin shtetëror të Shqipërisë konsiderohen të jenë ndër më të lartat në rajon dhe Evropë, sa i përket shkollimit publik. Shqipëria është një nga vendet më të varfra në Evropë me GDP prej 4,868 dollarë për kokë banori, ndërkohë që sipas Bankës Botërore në vitin 2017, është shpenzuar në arsim 2.49% të GDP, që është nën mesataren evropiane.

Bushati: Integrimi në BE, proces bashkues për politikën dhe shoqërinë



TIRANË, 13 DHJETOR - Projekti evropian i vendit duhet të jetë një proces bashkues, si për klasën politike shqiptare, edhe për shoqërinë në tërësinë e saj. Kështu deklaroi ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Dimitris Bushati, gjatë një takimi konsultativ me Këshillin Kombëtar të Integritimit Evropian, për projektvendimin për krijimin e strukturave negociuese me Bashkimin Evropian.

"Negociatat do të jenë një proces i vështirë, por që pritet të sjellin një transformim modernizues në funksionimin e administratës, bashkërendimin institucional, kapacitetet planifikuese dhe zbatuese, në hapjen dhe transparencën e politikëbërjes. Ky modernizim i administratës, i bashkuar me reformat për sundimin e ligjit, konsolidon shtetndërtimin demokratik", u shpreh Bushati. Ai theksoi se qeveria është e hapur

për dialog të vazhdueshëm me Parlamentin, shoqërinë civile, grupet e interesit, botën akademike. BE-ja, tha ai, bazuar në arritjet e Shqipërisë në procesin e reformave, ka përcaktuar tashmë rrugën për hapjen e negociatave të anëtarësimit, ndërkohë që me Komisionin Evropian ka filluar procesi i analizimit të legjislacionit tonë për të vlerësuar shkallën e përputhjes me legjislacionin e BE-së.

Papa Françesku viziton Maqedoninë

VATIKAN, 13 DHJETOR - Shenjtëria e Tij Papa Françesku, duke e pranuar ftesën e institucioneve më të larta të vendit dhe Kishës Katolike, më 7

maj të vitit 2019 do të realizojë udhëtim apostolik në Republikën e Maqedonisë, me ç'rast do të vizitojë qytetin e Shkupit - qytetin e

lindjes së Shenjtores Nënë Tereza. Programi i vizitës do të publikohet me kohë. Ndërkaq, nga data 5 deri më 7 maj,

Papa Françesku do të realizojë udhëtim apostolik në Bullgari, ku do të vizitojë qytetet Sofje dhe Rakovsk.



Kuvendi i Republikës së Kosovës do ta votojë sot pakon ligjore për transformimin e FSK-së në ushtri

Sot votimi historik për ushtrinë e Kosovës

Republika e Kosovës sot (e premte) zyrtarisht do të bëhet me ushtri. Të zgjedhurit e popullit do t'i votojnë tri projektligjet për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri. Votimit historik të Kuvendit për ushtrinë e Kosovës i ka paraprirë mbështetja e fuqishme e ShBA-së. Ambasadori amerikan në Kosovë, Philip Kosnett, ka thënë se votimi për transformimin e FSK-së është historik për Kosovën. Ndërsa presidenti Hashim Thaçi, i veshur me uniformë ushtarake, të enjten ka vizituar Kazermën "Adem Jashari", me ç'rast ka thënë se transformimi i FSK-së në ushtri është vendim i shumëpritur

**EPOKA
ERE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Deputetët e Kuvendit të Kosovës do të mbledhen sot (e premte) në orën 10:00 për ta votuar pakon ligjore për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri. Ligjvënësit do ta miratojnë në lexim të dytë Projektligjin për Ministrinë e Mbrojtjes, Projektligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Projektligjin për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Pas aprovimit të këtyre projektligjeve do të organizohet edhe ceremonia shtetërore për formimin e ushtrisë së Kosovës që do të mbahet në orën 17:00 në ambientet e Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Philip Kosnett, e ka quajtur historik votimin e tri projektligjeve për transformimin e FSK-së. Ai ka bërë me dije se ShBA-ja do ta mbështesë zhvillimin profesional dhe organizativ të FSK-së. "Votimi për tranzicionin e FSK-së është historik për Kosovën. ShBA-ja do ta mbështesë zhvillimin profesional dhe organizativ të FSK-së, e cila duhet të luajë një rol pozitiv për Kosovën dhe rajonin, duke reflektuar karakterin shumetnik të vendit dhe

përkushtimin e popullit të Kosovës për paqe", ka shkruar Kosnett në llogarinë e vet në "Twitter".

Diplomati amerikan ka thënë se seanca e së premtes e Kuvendit të Kosovës dhe ceremonia e FSK-së duhet të jenë raste për reflektim solemn dhe dedikim për paqe, stabilitet dhe prosperitet për Kosovën dhe fqinjët e saj. "Tani është koha për të gjithë liderët dhe faktorët ta fokusojnë energjinë në dialog", ka deklaruar ambasadori Kosnett.

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka ftuar grupin parlamentar të Listës Serbe që të marrë pjesë në seancën plenare për miratimin e pakos së ligjeve për transformimin e FSK-së në ushtri. Sipas KDI-së, pjesëmarrja e grupit parlamentar e Listës Serbe në këtë seancë do të jetë në funksion të integritetit dhe zhvillimit të vlerave demokratike të shoqërisë së Kosovës.

Deri më tani transformimi i FSK-së ka marrë mbështetjen e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Republikën e Kosovës, të cilët kanë kontribuar që ky proces të jetë gjithëpërfshirës, prandaj KDI-ja ka inkurajuar përfaqësuesit e Listës Serbe të bëhen pjesë e këtij procesi.

Edhe Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ka inkurajuar Kuvendin e Kosovës që t'i miratojë projektligjet për



Thaçi: Ushtria do ta mbrojë pavarësinë dhe integritetin territorial të Kosovës

Një ditë para votimit të Kuvendit për formimin e ushtrisë, presidenti i Kosovës, njëherësh komandanti suprem i Forcave të Sigurisë së Kosovës (FSK), Hashim Thaçi, i veshur me uniformë ushtarake, ka vizituar Kazermën "Adem Jashari". Me këtë rast ai ka thënë se transformimi i FSK-së në ushtri është vendim i shumëpritur. Thaçi ka deklaruar se ushtria e Kosovës do të jetë gjithmonë e gatshme për t'i shërbyer kultivimit dhe forcimit të paqes në vend, rajon dhe me gjerë. "Festat e fundvitit kësaj radhe janë më të veçanta. Kanë mbetur vetëm edhe disa orë deri te vendimi i shumëpritur. Ky proces po rrjedh natyrshëm si rezultat i punës dhe i përkushtimit tuaj të jashtëzakonshëm. Ushtria jonë do të jetë gjithmonë e gatshme për t'i shërbyer kultivimit dhe forcimit të paqes në vend, rajon dhe kudo që është e nevojshme në botë. Vendimi për ndryshimin e mandatit të FSK-së, duke i thënë

kësaj force kompetencat e ushtrisë së mirëfilltë, është më së shumti meritë e juaja ushtar dhe ushtar. Çdo qytetar i vendit sot duhet të ndihet krenar. Jam në mesin tuaj për t'ju falënderuar juve në emër të qytetarëve dhe institucioneve të Kosovës. Jam këtu për t'i uruar qytetarët për ushtrinë e Kosovës. Kosovë, urime ushtria!", ka deklaruar Thaçi.

Presidenti i vendit ka vlerësuar se rrugëtimi i FSK-së simbolizon ecjen dhe zhvillimin e shtetit të Kosovës. Sipas tij, FSK-ja ka kaluar shumë sfida deri më sot, por ia ka arritur qëllimit final. Thaçi ka thënë se populli ynë e ka krijuar ushtrinë para se ta fitojë lirinë, pavarësinë dhe shtetin.

"Nga ky muaj ju do të keni mision dhe mandat të ri si Forcë e Kosovës, respektivisht ju jeni ushtria e Kosovës. Do të shërbeni dhe do të mbronni me krenari pavarësinë dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës, duke kontribuar edhe për ruajt-

jen e stabilitetit rajonal dhe global. Zhvillimi i ushtrisë së Kosovës është i veçantë dhe i ndryshëm nga ushtritë e shumë shteteve të tjera. Populli ynë e krijoi ushtrinë para se ta fitojë lirinë, pavarësinë dhe shtetin. Më lejoni ta them një fakt që gjithmonë e keni ditur, për qytetarët dhe institucionet e Kosovës ju gjithmonë keni qenë ushtarë dhe FSK-ja ushtri e Kosovës", është shprehur Thaçi, duke shtuar se FSK-ja edhe me misionin e ri do të vazhdojë t'u shërbejë të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallime etnike. "I siguroj të gjitha komunitetet, veçanërisht komunitetin serb, se FSK-ja do të vazhdojë t'u shërbejë të gjithë qytetarëve në Kosovë pa dallime etnike. FSK-ja është institucioni më i besuar në Kosovë. Transformimi i FSK-së do të jetë faktor për stabilitetin në rajon dhe më gjerë. Si komandant suprem i ushtrisë e them me bindje të plotë se kjo forcë është dhe do të mbetet krenaria jonë", ka deklaruar Thaçi.



transformimin e FSK-së në një mandat mbrojtës. QKSS-ja konsideron se ky është një proces i logjikshëm shtetndërtues për të cilin është punuar intensivisht gjatë pesë vjetëve të fundit. Sipas kësaj qendre, është tejet e rëndësishme që ky proces të mos instrumentalizohet për përfitime personale e politike, mirëpo të transmetohet si një

arritur kombëtare për përfitime për Kosovën, rajonin dhe më gjerë.

QKSS-ja ka vlerësuar se tranzicioni i FSK-së në ushtri nuk do të ketë impakt të menjëherëshëm përderisa është një proces që do t'i marrë 7-10 vjet. "Ndërtimi i kapaciteteve të saj sigurisht se pritet të bëhet bazuar në mbështetjen bilat-

erale të shteteve përderisa NATO, ashtu sikurse në rastin e mandatit aktual, ka një hapësirë shumë të ngushtë veprimi për shkak të mungesës së konsensusit. Mandati i kufizuar për qëllime të vetëmbrojtjes është në shërbim të ruajtjes së paqes, jo luftës", është theksuar në komunikatën e QKSS-së.

Flet për "Epokën e re", Petrit Selimi

Ndihma e MCC-së është ftesë për p



Petrit Selimi, drejtor ekzekutiv i Fondacionit të Mileniumit të Kosovës, entitetit të përgjegjshëm implementues të programit të MCC-së në Kosovë, ka treguar se ndihma e MCC-së është ftesë për përparim të mëtutjeshëm në Kosovë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka folur për rëndësinë e vendimit të kësaj agjencie qeveritare amerikane për ndihmë të mëtutjeshme dhënë Kosovës. Ai ka pohuar se Kosova duhet të tregojë rezultate të mëtutjeshme në qeverisje të mirë, transparencë, kontroll të korrupsionit, që të kualifikohet për ndihma edhe më të mëdha dhe investime infrastrukturore. Sipas Selimit, pritet që investimet e mundshme, sidomos në sektorin e energjisë, të mbërrijnë në disa dhjetëra milionë dollarë

këtyre granteve", ka thënë Selimi. Ai ka treguar se si Kosova ka arritur ta avancojë statusin e vet në këtë program dhe si do të shpenzohen këto mjete. "MCC-ja është një organizatë që bazon vendimet në të dhëna empirike, pra në studime dhe në përparim të shteteve në përbushje të disa kushteve. Prandaj edhe e ka emrin 'sfidë' sepse sfidon shtetet që t'i përmbushin kushtet e ashpra, por fer të një qeverisje më të mirë, më transparente dhe lirive ekonomike. Kosova ka shënuar përparim në tre vjetët e fundit, por ky përparim duhet të jetë i qëndrueshëm", është shprehur ai, duke shtuar se është punuar me shumë agjenci të OKB-së për mbledhjen këtyre të dhënave. Selimi, i cili ka qenë edhe ish-zëvendësiministër i Punëve të Jashtme, ka folur edhe për

rëndësinë e mbështetjes që Amerika po i jep Kosovës në fusha të ndryshme. "Aleanca me Amerikën është shtylla kryesore e shumë proceseve që kemi pasur. Kjo aleancë nuk është vetëm e bazuar në interesa gjeostrategjike, por edhe në vlera të përbashkëta. Këto vlera duhet t'i ruajmë, përfshirë luftën për të drejtat e njeriut, dialogun me fqinjë, mbrojtjen e multiethnicitetit dhe trashëgimisë dhe dialogut ndërfaqet, por edhe luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar", ka thënë Selimi.

"Epoka e re": Z. Selimi, Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit MCC ka avancuar statusin e Kosovës në programet e saj. Çfarë do të thotë kjo për Kosovën?

Selimi: Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit - MCC është një

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Drejtori ekzekutiv i Fondacionit të Mileniumit të Kosovës, entitetit të përgjegjshëm implementues të programit të MCC-së në Kosovë, Petrit Selimi, ka treguar për

avancimin e statusit të Kosovës në këtë program. Ai ka deklaruar se kjo ndihmë është ftesë për përparim të mëtutjeshëm në Kosovë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Selimi ka thënë se Kosova duhet të tregojë rezultate të mëtutjeshme në qeverisje të mirë. "Vendimi i ri

amerikan nënkupton se Kosova ka të drejtë të përfitojë edhe disa dhjetëra milionë dollarë për projekte që ndihmojnë zhvillimin ekonomik. Kosova, megjithatë, e ka obligim të shënojë përparim në kontrollin e korrupsionit dhe në indikatorë të qeverisjes së mirë për ta mundësuar lëvrimin e

Ërparim të mëtutjeshëm në Kosovë

"Epoka e re": Për çfarë konkretisht do të shfrytëzohen këta dhjetëra milionë?

Selimi: Këto fonde do të bazohen në projekte që do të dizajnohen nga ekipet e përbashkëta të institucioneve të Kosovës dhe MCC-së. Pra, që nga janari MCC-ja do ta dërgojë një ekip ekspertësh, ndërsa edhe Kosova duhet të sigurojë që do të angazhohet të rekrutojë ekspertë të duhur si dhe të gjejë projekte kualitative që mund të konsiderohen nga MCC-ja. Është me rëndësi të ceket se në Kosovë MCC-ja dhe Qeveria e Kosovës tashmë janë pajtuar ta themelojnë një entitet implementues, Fondacionin e Mileniumit të Kosovës, të cilin e udhëheq unë, që e implementon grantin fillestar, Programin e Pragut, ndërsa tani paralelisht do të punohet edhe për dizajnimin e programit të dytë, apo Programin Kompakt që me siguri do të fokusohet në fushat që konsiderohen jetike për Kosovën sikurse energjia, sundimi i ligjit etj.

"Epoka e re": Sa ka qenë sfiduese për Kosovën që të fitojë grantin e dytë nga MCC-ja?

Selimi: MCC-ja është një organizatë që bazon vendimet në të dhëna empirike, pra në studime dhe në përparim të shteteve në përbashkësi të disa kushteve. Prandaj e ka emrin 'sfidë' sepse sfidon shtetet që t'i përbushin kushtet e ashpra, por fer të një qeverisje më të mirë, më transparente dhe të lirive ekonomike. Kosova ka shënuar përparim në tre vjetët e fundit, por ky përparim duhet të jetë i qëndrueshëm. Ne kemi punuar me shumë agjenci të OKB-së që mbledhin këto të dhëna. UNDP, OBSH, Banka Botërore, FMN janë disa prej organizatave që janë përfshirë në mbledhjen e këtyre raporteve. Është sfiduese të mblidhen këto të dhëna, të publikohen, po ashtu ne është dashur të tregojmë rezultat të matshëm dhe të pashëm për implementimin e marrëveshjes ekzistuese me MCC-në. Jemi të gëzuar që Bordi i MCC-së ka vlerësuar se ekipi ynë ka treguar rezultat të mirë dhe ka lansuar shpejt aktivitetet e financuara nga Programi i Pragut.

"Epoka e re": Ka kaluar një vit që Kosova ka përfituar grantin e parë të Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit prej 49 milionë dollarësh. Sa është realizuar ky grant?

Selimi: Tash e një vit Kosova, me ndihmën e MCC-së, ka themeluar entitetin MFK. Në hapje të entitetit kanë ardhur mysafirë si drejtori ekzekutiv i MCC-së, pastaj kongresmeni Engel etj. Kemi punuar për përfundimin e

studimeve të fizibilitetit dhe dizajnimin të projekteve, ndërsa që nga dhjetori do ta fillojmë implementimin. Viti i ardhshëm është viti kur kompanitë implementuese, që do të jenë me renome ndërkombëtare, do t'i fillojnë projektet si instalimi i njehsorëve në banesat me ngrohje qendrore, apo përmirësimi i efikasitetit energjetik të banesave dhe ekonomive familjare në mbarë Kosovën. Ne, po ashtu, kemi nisur tashmë një projekt për hapjen e të dhënave qeveritare dhe kemi ndarë grante për shoqërinë civile në projektin që synon rritjen e transparencës qeveritare. Pra, MFK-ja ka përbushur pritjet nga MCC të operacioneve të vitit të parë dhe tash do të fillojë edhe viti i dytë që

nënkupton investimet në terren.

"Epoka e re": Përveç mbështetjes në fushën ekonomike, ShBA-ja po e mbështet Kosovën edhe në fusha të tjera. Tani kemi mbështetjen në fushën e sigurisë për formimin e ushtrisë. Si ish zëvendësministër i Jashtëm, si po e shihni këtë mbështetje amerikane për Kosovën në këtë fazë të rëndësishme?

Selimi: Amerika dhe organizatat e ndryshme, por edhe sektori privat, ka ndihmuar Kosovën në të gjitha fazat e luftës për liri dhe shtetformim. Ata kanë ndihmuar ndërtimin dhe reformimin e një sistemi gjyqësor për mbajtjen e sigurisë nëpërmjet forcave ushtarake, ka ndihmuar në investime private siç është rasti i inves-

timeve që pritet të vijnë në Termocentralin Kosova e Re. Tash po shihet edhe roli i madh mbështetës për transformimin e FSK-së. Pra, aleanca me Amerikën është shtylla kryesore e shumë proceseve që kemi pasur. Kjo aleancë nuk është vetëm e bazuar në interesa gjeostrategjike, por edhe në vlera të përbashkëta. Këto vlera duhet t'i ruajmë, përfshirë luftën për të drejtat e njeriut, dialogun me fqinjë, mbrojtjen e multiethnicitetit dhe trashëgimisë dhe dialogut ndërfetar, por edhe luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Këto vlera të përbashkëta do të na hapin edhe dyert e NATO-s dhe do të na sigurojnë për shumë mot si anëtarë të denjë të familjes së kombeve atlantike.

Presidenti shpalli dekretin për tetë ligje të sektorit të drejtësisë

PRISHTINË, 13 DHJETOR (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, duke u bazuar në kompetencat e veta kushtetuese, të enjten ka shpallur dekretin për tetë ligje të sektorit të drejtësisë, të miratuara nga Kuvendi i Kosovës.

Thaçi ka dekretuar pakon e ligjeve për reformën në sistemin e drejtësisë, përkatësisht Kodin Penal, Ligjin për Gjykatat, Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të

Kosovës, Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Trashëgiminë në Kosovë, si dhe Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Procedurën Jokontestimore.

Presidenti Thaçi e ka vlerësuar lart punën e bërë për reformimin e sektorit të sundimit të ligjit. "Efikasiteti i sundimit të ligjit është jetik për funksionimin e demokracisë. Arsimimi, shëndetësia dhe politikat e punësimit nuk mund të avancohen pa qasje të shpejtë në drejtësi. Për të rinjtë, drejtësia është mundësia e vetme për të ardhme më të mirë", ka thënë Thaçi. Ai ka

kërkuar nga institucionet ligjzbatuese të këtij sektori që ta jetësojnë ndryshimin, duke zbatuar ligjet dhe duke mbrojtur interesin publik të qytetarëve. "Lufta e vazhdueshme e institucioneve të Kosovës kundër korrupsionit nuk është vetëm plotësim i standardeve të kërkuara nga BE-ja, por është domosdoshmëri", u shpreh presidenti Thaçi.

Kreu i shtetit ka theksuar se ky është obligim që kemi marrë ndaj qytetarëve për ta përmirësuar mirëqenien e tyre dhe ndaj shtetit tonë për t'i kontribuar ndërtimit të një shteti të fortë të së drejtës.



agjenci federale amerikane e ngjashme me USAID-in. Pra, është pjesë e qeverisë amerikane që ndihmon shtetet me fonde zhvillimore. Bordi i MCC-së, që kryesohet nga sekretari i Shtetit Mike Pompeo, ka vendosur ta kualifikojë Kosovën për grantet kompakt. Kosova ka një histori me MCC-në që më herët pasi kjo agjenci tashmë ka ndarë 49 milionë dollarë për Kosovën dhe këto mjete që nga viti i ardhshëm do të investohen në mbarë Kosovën. Vendimi i ri amerikan nënkupton se Kosova ka të drejtë të përfitojë edhe disa dhjetëra milionë dollarë për projekte që ndihmojnë zhvillimin ekonomik. Kosova, megjithatë, e ka obligim të shënojë përparim në kontrollin e korrupsionit dhe në indikatorë të qeverisjes së mirë për ta mundësuar lëvrimin e këtyre granteve.

Thellohet bashkëpunimi ekonomik në mes të Kosovës dhe Japonisë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Në ditën e dytë dhe të fundit ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka qëndruar në Tokio të Japonisë, ku është takuar me zyrtarë të lartë shtetërorë për të siguruar përkrahje për projekte të ndryshme zhvillimore, përfshirë termocentralin "Kosova e Re". I shoqëruar nga ambasadori i Kosovës në Japoni, Leon Malazogu, ministri Lluka ka takuar Yoshihiro Seki, ministër Shtetëror për Ekonomi, Tregti dhe Industri dhe deputet në Parlamentin Japonez, me të cilin ka diskutuar përkrahjen e Qeverisë Japoneze për projektin më të madh në historinë e Kosovës, ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re".

Ministri Seki ka potencuar se ministria që ai drejton është duke e shikuar me kujdes zhvillimin e projektit dhe ka premtuar përkrahjen e plotë duke kuptuar situatën që gjendet Kosova, ku burim të vetëm energjetik ka thëngjillin. Për më tepër, në këtë takim u diskutua edhe për forumin biznesor që do të mbahet në muajin shkurt në Kosovë në mes të bizneseve vendore dhe atyre nga Japonia, forum ky i përkrahur edhe nga Qeveria Japoneze.

Me këtë rast, ministri Lluka e ka informuar homologun për përfitimet e kompanive japoneze nëse operojnë në Kosovë, ku synim parësor kanë eksportin e produkteve në tregun evropian. Ndër të tjera, Lluka ka potencuar se fuqia e lirë punëtore, tatimet e ulëta në fitim dhe në të ardhura personale, taksa prej 0 përqindësh për dividendë, pozicioni gjeografik i Kosovës që jep qasje të lehtë në tregun e Bashkimit Evropian, marrëveshja për tregti me BE-në e cila hap dyert në treg prej 600 milionë banorësh dhe potenciali për të shfrytëzuar tokë publike deri në 99 vjet ofrojnë mundësi të jashtëzakonshme për çdo investitor japonez që dëshiron ta targetoj tregun evropian.

Delegacioni nga Kosova është pritur në takime të veçanta nga Tadashi Maeda, guvernator dhe drejtori i përgjithshëm i Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JBIC) dhe Masafumi Nakada, president i agjencisë shtetërore për sigurimin e eksporteve dhe investimeve (NEXI) me të cilët është diskutuar mbështetja financiare në projektin e Kosovës së Re.

Qëllimi i takimit ishte për t'i informuar këto institucione të rëndësishme rreth nevojave dhe sfidave të Kosovës për sektorin energjetik si dhe për të kërkuar



mbështetje për projekte të tjera në fushën e infrastrukturës. Për më tepër, Lluka ka kërkuar mbështetjen financiare në projektet për menaxhimin e mbeturinave, kryesisht në riciklimin e mbeturinave dhe gjenerimin e

energjisë elektrike dhe termike nga mbeturinat, projekt ky që do ta rregullonte situatën e mbeturinave, deponive të mbeturinave dhe, njëkohësisht, përveç një ambienti më të pastër, qytetarët do të përfitonin

edhe energji të pastër me potencial të zgjerimit të kapaciteteve të ngrohtoreve të qyteteve më të vogla. Ky projekt zgjoi interesim te guvernatori Maeda, ku edhe u pajtuam që projekti të vazhdojë të zhvillohet tutje.

Haxhi Bejta zgjedhet kryetar i nëndegës së PDK-së në Prekaz



SKENDERAJ, 13 DHJETOR (ER) - Kuvendet zgjedhore të nëndegëve të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) po vijojnë në tërë Kosovën. Nga 1 200 nëndegë të PDK-së që ka në nivel Kosovës, deri tani janë mbajtur 70 kuvende. Në këto 70 kuvendet e para zgjedhore, në procesin zgjedhor, sipas

Komisionit Zgjedhor të PDK-së, kanë marrë pjesë rreth 4 000 delegatë. Të mërkurën u mbajtën kuvendet zgjedhore në disa nëndegë si në Prekaz të Epërm, Rashincë dhe Muzeçinë.

Në Prekaz të Epërm, me pjesëmarrjen e mbi 200 delegatëve, u zgjodhën organet drejtuese të

nëndegës së PDK-së. Me këtë rast, sipas Komisionit Zgjedhor, u zgjodh Kryesia e nëndegës me 11 anëtarë dhe tetë delegatë për kuvendin e degës.

Kryetar i nëndegës në Prekaz të Epërm me votim të fshehtë u zgjodh Haxhi Bejta i cili mori besimin e shumicës së delegatëve të

pranishëm. Ai me këtë rast i falënderoi të pranishmit për besimin e dhënë dhe u zotua se do ta bëjë më të mirën për platformën e Dekadës së Re, si të vetmes platformë të qartë, me besim, zhvillim dhe integritet.

Të pranishëm në këtë proces zgjedhor ishin edhe kryetari i

Degës së PDK-së në Skenderaj, Sami Lushtaku, nënkryetari i komunës, Nuredin Lushtaku, deputetët e Kuvendit të Kosovës nga kjo anë, Blerta Deliu, Ganimete Musliu, Bekim Haxhiu, Rafet Rama, personalitete të tjera të kryesisë qendrore dhe të Degës së PDK-së në Skenderaj.



Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) prezanton rezultatet e punës për vitin 2018

Sejdiu: Në vitin 2019 spitalet rajonale do të jenë prioritet kryesor

Drejtori i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK), dr. Basri Sejdiu, ka thënë të enjten se kur ka ardhur në krye të kësaj detyre, sistemin e shëndetësisë e ka gjetur në gjendje të rëndë. Ai ka thënë se mobilizimi i përgjithshëm, bashkëpunimi dhe përkrahja e ngushtë e Ministrisë së Shëndetësisë ka dhënë rezultate të mëdha në këtë sektor

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka prezantuar të enjten rezultatet e punës për vitin 2018 dhe planin e punës për vitin 2019. Drejtori i ShSKUK-së, dr. Basri Sejdiu, ka thënë se kur ka ardhur në krye të kësaj detyre, sistemin e shëndetësisë e ka gjetur në gjendje të rëndë. Ai ka bërë me dije se ka kërkuar intervenim të shpejtë për t'i identifikuar problemet me qëllim të përmirësimit të sit-

uatës. "Sistemin shëndetësor e kemi gjetur në një gjendje të rënduar, një fakt që na kërkuar të reagojmë menjëherë. Kemi vendosur që pacienti të jetë në qendër dhe të gjitha aktivitetet janë zhvilluar në këtë drejtim. Janë marrë masa urgjente që situata të përmirësohet në nivel të sigurisë, duke filluar nga porta hyrëse, infrastruktura, ambientet e punës, kemi siguruar stafin mbështetës si dhe pajisjet me të cilat do të punohet", ka thënë Sejdiu.

Ai ka shtuar se mobilizimi i përgjithshëm, bashkëpunimi

dhe përkrahja e ngushtë e Ministrisë së Shëndetësisë ka dhënë rezultate të mëdha, sidomos në Kardiologji Invazive dhe Kardiokirurgji. "Njësia Koronare dhe Kardiologjia Invazive, së bashku me Kardiokirurgjinë, janë rezultate të jashtëzakonshme, ku që nga 1 shkurti, me ngritjen e shërbimeve 24 orësh, asnjë pacient nuk kërkon trajtim jashtë institucioneve tona publike. Kjo ka ngritur performancën e mjekëve, ka kursyer buxhetin dhe ka krijuar lehtësime për pacientët tanë", është shprehur Sejdiu. Duke folur për vitin 2019, ai ka theksuar se spitalet rajonale do të jenë prioritet kryesor.

Ndërsa ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thënë se viti 2018 ishte intensiv, pasi janë shënuar suksese të jashtëzakonshme falë punës së madhe të punëtorëve shëndetësorë. "Kemi parë që kur i jepet prioritet shëndetësisë, edhe punëtorët shën-

detësorë i dalin krah punës. Kur u japim mundësi investimeve në sektorin e shëndetësisë, që nga infermierët, ashtu edhe mjekët dhe gjithë profesionistët shëndetësorë do të jenë në gjendje ta kthejnë dinjitetin në spitalet tona, që e kemi kërkuar për vite me radhë. Qëllimi yni është që pacientët në Kosovë, në kohë nevojë, ta shohin sistemin tonë shëndetësor si një derë ku mund të shohin dhe marrin shërim", ka deklaruar Ismaili. Sipas Ismailit, në mungesë të përkujdesjes institucionale, për një kohë të gjatë ka pasur një degradim të sistemit shëndetësor dhe për shkak të kësaj gjendje kanë pësuar të gjithë. "Ne kemi parë një demoralizim, ndoshta të punëtorëve shëndetësorë, mungesë të pajisjeve, mungesë të aparaturave të ndryshme, të cilat e kanë limituar potencialin e mjekëve. Por, në anën tjetër, edhe varfërim të popullatës. Sot kemi filluar investimet e mëdha,

po e rrisim buxhetin nga viti në vit, jemi të impenjuar që ta shohim rritjen e pagave të punëtorëve shëndetësorë", ka thënë Ismaili. Ai ka folur edhe për sigurimet shëndetësore, duke thënë se vitin e ardhshëm do t'i jepet rëndësi e veçantë kësaj çështjeje. Dardan Parduzi, shef i sektorit për kontraktimin e shërbimeve shëndetësore, ka bërë prezantimin e rezultateve në të cilat përfshihen investimet në aparatura të reja mjekësore, infrastrukturë dhe të tjera, e që kanë ndikuar në përmirësimin e kushteve të punës jo vetëm për stafin shëndetësor, por edhe për pacientët. Prezantimin e rezultateve të punës për Spitalin e Gjilanit e bëri drejtori Nisret Hajrullahu, ndërsa për Spitalin e Prizrenit, Afrim Avdaj, Prezantimi i rezultateve të punës për vitin 2018 dhe planin të punës për vitin e ardhshëm për ShSKUK-në u mbështet nga Ambasada e Luksemburgut.

Haradinaj prezanton draftmarrëveshjen për normalizimin e raporteve me Serbinë



Prishtinë, 13 dhjetor (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka takuar të enjten ambasadorët e vendeve të Quintit, të cilëve ua ka paraqitur draftin e parë të marrëveshjes gjithëpërf-

shirëse, ligjërisht obliguese ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. Ai ka treguar se ky draftdokument është dokument mbështetës për procesin ekzistues të dialogut si dhe

aspektet që ndërlidhen me përshejtimin e këtij procesi. "Shefi i dialogut teknik, Avni Arifi, ka prezantuar kapitujt që për ne do të përbëjnë parametrat kryesorë të marrëveshjes, e cila do t'i hapë rrugë normal-

izimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Draftdokumenti me anekset përcjellëse u është dorëzuar edhe të gjithë bartësve të institucioneve dhe kryetarëve të të gjitha subjekteve politike. Në ditët dhe javët

në vijim ky draftdokument do të diskutohet me të gjitha palët në shoqërinë tonë, për të arritur te dokumenti përfundimtar, ku do të përfshihet ekspertiza e të gjithëve", ka thënë kryeministri Haradinaj pas takimit.

Kërkohet buxhet për shkollat shqipe në diasporë

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje!, Glauk Konjufca, ka kërkuar nga ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, që të koordinohet me kryeministrin dhe të ndahet buxhet nga shteti i Kosovës për fëmijët shqiptarë në diasporë për mësim në gjuhën shqipe. Nëse një gjë e tillë nuk bëhet, sipas Konjufcës, atëherë pas 30 apo 40 vjetësh ata rrezikojnë ta humbin identitetin kombëtar

mijë fëmijë në diasporë dhe shteti i Kosovës duhet ta marrë për barrë shkollimin e tyre, në të kundërtën rrezikojmë ta humbin identitetin kombëtar pas 30 apo 40 vjetësh", ka deklaruar Konjufca.

Po ashtu, vërejtje për punën e ministrit Gashit ka dhënë edhe deputetja tjetër e LV-së, Fitore Pacolli, e cila ka thënë se Ministria e Diasporës nuk e ka informuar me kohë diasporën për dëgjimet publike. "Ne kemi pasur takime të shumta në Francë, në Suedi, në Turqi dhe nuk ka pasur informim të duhur se kur janë dëgjimet publike me ta. Në Turqi e dimë se si janë shpërngulur dhunshëm ata. Nuk

u është përkthyer projektligji në gjuhën turke pasi dihet se disa prej shqiptarëve atje e kanë të vështirë praktikumin e gjuhës shqipe. Edhe diskutimi në Berlin ka dështuar pasi vetëm tre veta ishin të pranishëm. Pra, pothuajse çdo takim e bënim ad-hoc", ka thënë Pacolli.

Ministri Gashi në përgjigjet e tij ka theksuar se sa i përket mësimin në gjuhën shqipe dhe programit televiziv janë në koordinim me shtetin shqiptar që të bëhet një koordinim i përbashkët. Ai ka thënë se në këtë drejtim problemi qëndron te shteti shqiptar për koordinimin financiar. Sipas Gashit, po kërkohet program për diasporën, e jo kanal i veçantë.

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, ka raportuar të enjten para anëtarëve të Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike. Para anëtarëve të këtij komisioni, ai ka shpalosur planin

për Ligjin për diasporën si dhe u është përgjigjur pyetjeve të deputetëve. Puna e tij është kritikuar për mosefikasitet dhe informim në kohë të duhur sa iu përket dëgjimeve publike me diasporën.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje!, Glauk Konjufca, ka kërkuar nga ministri Gashi të koordinohet me kryeministrin dhe të ndahet bux-

het nga shteti i Kosovës për fëmijët shqiptarë në diasporë për mësim në gjuhën shqipe. Nëse një gjë e tillë nuk bëhet, sipas Konjufcës, atëherë pas 30 apo 40 vjetësh ata rrezikojnë ta humbin identitetin kombëtar. "Ju ftoj të jeni më fleksibil në punën tuaj. Kam thënë edhe më herët se deri në prill s'mund ta kemi një ligj për diasporën. Janë rreth 200



Studentët e Kosovës dhe ata evropianë përfundojnë praktikën profesionale në BQK

PRISHTINË, 13 DHJETOR (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka ndarë certifikatat për studentë të universiteteve dhe kolegjeve që përfunduan me sukses programin e praktikës për vitin 2018 në BQK. Guvernatori Mehmeti ka përgëzuar studentët për punën e tyre të bërë, duke i inkurajuar ta vazhdojnë angazhimin. "Banka Qendrore e Republikës së Kosovës do të vazhdojë të mbështesë këtë program, duke ua ofruar mundësinë të gjithë studentëve që të mësojnë për praktikën më të mira ndërkombe. Organizimi i kësaj praktike tradicionale ka për qëllim t'u mundësojë studentëve lidhjen midis njohurive teorike të fituara gjatë studimeve dhe punës praktike në institucionet publike të pavarura", ka deklaruar Mehmeti. Ndërsa studentët kanë falënderuar gjithë stafin e BQK-së për



gatishmërinë që t'u ndihmojnë për kryerjen me sukses të praktikës. Programi i praktikës për studentë, i ofruar nga BQK-ja, zgjatë një muaj dhe e veçanta e këtij viti ishte pjesëmarrja e stu-

dentëve nga Gjermania dhe Italia. Objektivi kryesor i këtij programi është që me studentët e përzgjedhur të ndahen përvojat e stafit të BQK-së dhe të realizohen pro-

jekte konkrete, ndërsa përzgjedhja e kandidatëve të suksesshëm bëhet duke marrë parasysh rezultatet e tyre në studime dhe shkallën e motivimit për të bërë praktikë profesionale në BQK.

Gjatë praktikës studentët e përzgjedhur janë vendosur nëpër njësi organizative të caktuara të BQK-së dhe kanë punuar nën udhëzimet e mbikëqyrësve të njësive përkatëse.

Starton 'Njësia B1', KEK-u në prodhim me kapacitete të plota



PRISHTINË, 13 DHJETOR (ER) - Pas një remonti kompleks, "Njësia B1" e Termocentralit "Kosova B" është kthyer në prodhim. Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) nga dita e enjte është në prodhim me kapacitete të plota. Prodhimi vendor nga termocentralet e KEK-ut tanimë është rreth 800 megavat orë energji elektrike. "Kemi përfunduar me sukses një

proces shumë sfidues dhe kompleks të riparimit të turbinave dhe gjeneratorit në njësinë "B1". Gjatë dy ditëve të fundit janë kryer me sukses të gjitha testet e komisionit në sistemin e turbinave dhe gjeneratorit. Kurse dje është bërë ndezja e sistemit të kaldajës, proces ky i cili pastaj ka vazhduar me komisionimin e nxehtë në sistemin e turbinave,

gjeneratorit G1 dhe pas testimit të suksesshëm, pas mesnatës së datës 12. 12. 2018, është bërë sinkronizimi i 'Njesisë B1' në sistemin", ka thënë drejtori menaxhues i KEK-ut, Njazi Thaçi. Sipas tij, falë angazhimit maksimal të të gjithë aktorëve në proces, lëshimi në operim i kësaj njësie është bërë dy ditë para planit dinamik të paraparë. "Për informim, sot

nga ora 01.54 e mëngjesit KEK është duke prodhuar me kapacitetin maksimal prodhues në termocentralet e 'Kosovës A' dhe 'Kosovës B', respektivisht me njësitë gjeneruese A3, A4, B1 dhe B2 dhe me kapacitet maksimal prodhues prej 800 megavatesh orë energji elektrike", ka bërë me dije Thaçi. Korporata Energjetike e Kosovës

është e licencuar vetëm për prodhim të energjisë elektrike dhe e cila operon konform licencës, ndërsa përgjegjësinë për shpërndarje dhe furnizim, duke përfshirë edhe importin kur konsumi është me i madh sesa prodhimi, e kanë kompanitë e tjera të licencuara në treg, në këtë rast, KEDS/KESCO si operator i shërbimeve universale.

Tahiri: Gjyqësori efikas, mundësia e vetme për investime dhe ndërmarrësi



PRISHTINË, 13 DHJETOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka takuar të enjten profesorët dhe studentët e Fakultetit Juridik, në kuadër të kampanjës "Drejtësia dhe biznesi", me të cilët ka biseduar për çështje të drejtësisë komerciale dhe mbi alternativën e themelimit të një gjykate të specializuar në çështje komerciale. Ministri Tahiri ka potencuar rëndësinë e rritjes së kapaciteteve të gjykatave në trajtimin e lëndëve të fushës tregtare, meqenëse

aktualisht kjo është barrë e vetëm një departamenti në kuadër të Gjykatës Themelore të Prishtinës. "Kemi ende sfida për plotësimin e kapaciteteve të kësaj natyre. Nuk do të rrimë indiferentë përballë këtij fakti. Nuk mund të lejojmë që bizneset vendore dhe ato të huaja ta luhatin besimin në institucionet e drejtësisë. Jemi duke kërkuar alternativa dhe kësaj i kontribuon edhe përvoja dhe dija juaj", ka thënë Tahiri. Ai ka përmendur si mangësi edhe mungesën e profilizimit të gjyq-

tarëve, duke bërë me dije se për këtë gjë ka biseduar edhe me drejtuesit e Ministrisë së Drejtësisë të Gjermanisë, me të cilët janë pajtuar për trajnime dhe profilizime të mëtejme të gjyqtarëve në trajtimin e çështjeve komerciale. Përveç forcimit të profesioneve të lira ligjore, që lehtësojnë qasjen në drejtësi, ministri Tahiri ka potencuar se efikasiteti i gjyqësorit do ta mundësojë tërheqjen e investimeve të huaja dhe zhvillimin e ndërmarrësisë.

Lekaj i njofton kryetarët dhe përfaqësuesit e komunave për projektin e autostradës së Dukagjinit

PRISHTINË, 13 DHJETOR (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka prituri të enjten në takim kryetarët dhe përfaqësuesit e komunave nëpër të cilat do të kalojë autostrada e Dukagjinit. Ai ka njoftuar për variantet e prezantuar nga kompania si dhe variantin e përzgjedhur nga kompania si më i favorshmi për realizim. Ministri Lekaj u kërkoi atyre t'i paraqesin sugjerimet dhe

komentet e tyre në mënyrë që ky projekt të realizohet në harmoni me vullnetin dhe nevojat e qytetarëve të vendit. Kompania projektuese e autostradës së Dukagjinit ua prezantoi në mënyrë të detajuar kryetarëve dhe përfaqësuesve të komunave të tre variantet e propozuar, duke i njoftuar ata edhe me variantin e përzgjedhur nga ta si kompani projektuese, e i cili, sipas

tyre, është më i realizueshmi si për nga kostoja financiare, po ashtu edhe për nga ndikimi ambiental dhe socio-ekonomik. Kryetarët dhe përfaqësuesit i dhanë vlerësimet e tyre fillestare, vlerësime këto që do të detajohen gjatë debateve publike që do të mbahen nëpër të gjitha komunat që prekën nga autostrada, në mënyrë që t'i hapet udhë edhe projektimit final të kësaj autostrade.



Në Malishevë largohen dy pika të mbeturinave inerte

MALISHEVË, 13 DHJETOR (ER) - Në fshatin Drenoc dhe Carrallukë të Komunës së Malishevës janë larguar dy pika ilegale të mbeturinave inerte. Ky aksion është ndërmarrë nga Komuna e Malishevës, përkatësisht Drejtoria e Shërbimeve Publike, në kuadër të aksionit nacional "Ta pastrojmë Kosovën" dhe është realizuar në bashkëpunim me ndërmarrjet lokale në Malishevë. Sipas koordinatorit komunal, Naser Morina, ky aksion është

realizuar në bashkëpunim me ndërmarrjen ndërtimore "Burimi", e cila me makinerinë e vet ka bërë largimin e mbeturinave inerte në këto dy deponi. Ai ka bërë me dije ky aksion është duke vazhduar. "Edhe në ditët në vijim do të ketë aksione të këtilla për largimin e pikave apo deponive ilegale të mbeturinave, kryesisht të mbeturinave inerte, të cilat paraqesin problem më të madh për ambientin", ka thënë Morina.



Prokuroria e Prizrenit sekuestron arsenal armësh

PRIZREN, 13 DHJETOR (ER) - Prokuroria Themelore në Prizren, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, pas një hetimi të gjatë, duke përdorur teknikat speciale të hetimit dhe vëzhgimit, ka arritur të arrestojë një grup të të dyshuarve, me inicialet B. S., L. Sh., P. T. dhe F. Xh., nën

dyshimin se kanë kryer në vazhdimësi katër vepra penale si blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotrope: importim, eksportim, furnizim, transportim, prodhim, këmbim, ndërmjetësim ose shitja e paautorizuar e

armëve apo materieve plasëse. Prokuroria dhe policia lidhur me këtë rast kanë zhvilluar bastisje në katër lokacione të ndryshme, duke përfshirë shtëpitë dhe lokalet përcjellëse të të dyshuarve dhe kanë arritur të sekuestrojnë prova materiale të rëndësishme për hetim.

Haziri e quan lajm të mirë nënshkrimin e marrëveshjes për Programin Nacional për Rininë

GJILAN, 13 DHJETOR (ER) - Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Kosovës, Rexhep Hoti, ka nënshkruar të enjten marrëveshje bashkëpunimi me kryetarin e Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, për implementimin e Programit Nacional për Rininë për të gjithë nxënësit dhe studentët e kësaj komune.

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka cilësuar lajm të jashtëzakonshëm Programin Nacional për Rininë duke qenë i bindur në suksesin e tij. "Sinqerisht, ka kohë që nuk kam dëgjuar lajm më të mirë nga Qeveria. Kemi zbrazëti të aktiviteteve nëpër shkolla dhe për këtë nxënësit duhet të bëhen aktivë. Ata duhet ta kuptojnë rëndësinë e garës dhe konkurrencës. Ky program do t'u mësojë atyre se nuk është lehtë të fitosh dhe do t'i motivojë për mësim. Unë më shumë dëshiroj do ta mbështes programin dhe do të ndihmojmë me të gjitha kapacitetet që ka komuna jonë", ka thënë Haziri.

Ndërkaq Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Kosovës, Rexhep Hoti, ka thënë se Programi Nacional për Rininë nuk është program



politik dhe nuk ka të bëjë me politikën. "Kjo po dëshmohet sot me mbështetjen që kryetari Haziri po na ofron. Për herë të parë qeveria po kthehet ekskluzivisht sepse ky program është hartuar për secilin nxënës të secilës shkollë, duke filluar nga niveli fillor, i mesëm i ulët dhe niveli i mesëm i lartë. Ky program parasheh përfshirjen e të gjithë nxënësve dhe studentëve në garë dhe pres që të gjithë ata të përfitojnë nga ky program jo vetëm

përmes shpërblimeve që do të ndahen, por edhe në aspektin fizik, mendor dhe të dijes", u shpreh koordinatori Hoti. Memorandumi i nënshkruar nga Hoti dhe Haziri parasheh bashkëpunimin dhe asistimin e ndërsjellë për implementimin e Programit Nacional për Rininë si dhe aranzhimin e përbashkët të aktiviteteve që kanë për synim promovimin e diturisë, kreativitetit kulturor dhe mendimit kritik si dhe sportit.

Kryetari i Rahovecit fton qytetarët ta përcjellin bashkë seancën për ushtrinë

RAHOVEC, 13 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, i ka ftuar familjarët e dëshmorëve, veteranëve dhe invalidëve të luftës që nesër t'i bashkohen në sallën e Kuvendit Komunal për ta ndjekur seancën e votimit për formimin e ushtrisë së Kosovës. "Jeni të ftuar që nesër, më 14 dhjetor, nga ora 10:00, bashkë në sallën e Kuvendit Komunal, ta ndjekim seancën ku do të

votohet formimi i Ushtrisë së Kosovës. Pa kontributin tuaj të pasqorë sot nuk do të gëzonim as lirinë, as shtetin e as ushtrinë, andaj kam dëshirë që këtë ditë historike ta ndajmë e përjetojmë bashkë. Po ashtu, janë të ftuar të gjithë qytetarët e interesuar që të na bashkohen në këtë ditë të madhe për Kosovën", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Rahovecit.



A do ta rrëzojnë studentët Edi Ramën?



Nga Bedri ISLAMI

Duhet të ishte Qeveria përballë studentëve, por është vetëm shefi i Qeverisë, Rama.

Ministrja e Arsimit, Lindita Nikolla, si duket e përfundoi misionin e vet: qëndrimi ose largimi i saj nga posti ministror është tashmë një formalitet i cili nuk çon më peshë. Edi Rama mori përsipër gjithë riskun e mbështetjes ose të shuarjes së

një lëvizje studentore, e cila, kur nisi, pakkush, as vetë ai, nuk e mendoj se do të merrte këto përmasa dhe, për më tepër, do të ndizte edhe vatra të tjera proteste pa lidhje me studentët. Jam i bindur se, edhe nëse një ditë ai do t'i bindë studentët për dialog me to, do ta ketë të vështirë, në mos të pamundur, të marrë me vete një ministër, një drejtues të lartë, pasi vetë statura e tyre përballë studentëve do të krijonte alergji. Me titullarë të lartë institucionesh të majmur nga pangopësia është shumë e vështirë, në mos e pamundur, të dialogosh qetësisht.

Lehtësia me të cilën Rama mori përsipër në mandatin e dytë ta drejtonte vendin me po ata njerëz, të cilët në mandatin e

parë nuk u shquan për gjë tjetër, veçse për shitje tenderësh, duhet analizuar. Ashtu si edhe mendjelehtësia fillestare me të cilën mori përsipër të përballej me studentët "ngelës".

Në varësi të qëndrimit që do të mbajë janë tri gjëra në lojë: jeta politike (tani është në tehun e thikës, ose duhet të fillojë ta bëjë kthesën e domosdoshme të shumëpritur, ose do të shkojë më tej, së bashku me karrocën e tij qeveritare drejt greminës) karriera si shef qeverie (tashmë jo të gjithëve u intereson në atë thellësi si dikur) dhe fati i forcës politike që ai drejton.

Jeta politike e Edi Ramës është fati i tij personal. Mund të rrijë në politikë ose mund të ikë nga politika. Një rastësi e ka sjellë, një lëvizje e fuqishme mund ta

largojë. Si shef qeverie nuk është as tragjike dhe as kërcënuese nëse bie. Por së bashku me të do të bjerë edhe qeveria e tashme dhe në rrethanat e sotme vendi mund të futet në një spirale të panjohur. I panjohur mbetet edhe fati i forcës politike që ai drejton, e cila në këto dekada pluralizëm ka qenë forca më moderne, më shpresëdhënëse, më tolerante dhe më progresive. Përballë studentëve Edi Rama ka tri mundësi:

1. T'i miratojë symbyllur të gjithë kërkesat e tyre, megjithëse e di fare mirë se kostoja e tyre do të jetë e lartë jo vetëm për qeverinë e tij, por edhe për të ardhmen; 140 mijë studentë në Shqipëri me të gjithë kërkesat e tyre i kushtojnë shtetit rreth 250 milionë euro në vit;

2. T'i refuzojë symbyllur të gjithë kërkesat e tyre dhe atëherë duhet të jetë i gatshëm të marrë mbi vete pasojat që mund të rrjedhin nga vendimi i tij;

3. Të arrijë ta gjejë dialogun, duke gjetur tani, kur duhej të ishin gjetur më parë, ato rrugë që sjellin shfryrjen e zemërimit dhe të rebelimit studentor.

Ka përpara vetes një shumësi studentore, të ngazëllyer nga vetja, të mbushur me besim, të mbushur me nxitimin për të bërë gjithçka përmes revoltës brenda së cilës, sot, në mos që mbrëmë, kanë hyrë edhe kthetrat e manipulatorëve. Risku që ka marrë për vete Edi Rama është i lartë, në dukje i papërballueshëm por, në fakt, ai risk është edhe e ardhmja e tij. Humbja do të jetë fatale.

Bahtiri i shqetësuar për moshapjen e urës mbi lumin Ibër



MITROVICË, 13 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur në takim ambasadorin e Finlandës në Kosovë, Pia Stjernvall, me të cilën ka biseduar për zhvillimet në vend dhe bashkëpunimin e Kosovës me Finlandën. Kryetari Bahtiri ka falënderuar mysafirët për interesimin për Mitrovicën dhe mbështetjen e vazhdueshme që Finlanda dhe populli i saj i kanë dhënë Kosovës dhe Mitrovicës. Ai ka thënë se është i

bindur se bashkëpunimi i mirë i kësaj komune me përfaqësuesit diplomatikë finlandezë do të vazhdojë edhe më tutje. "Nga një qytet me plot probleme politike, të sigurisë, zhvillimore, ndërtnike etj., Mitrovica sot është një ndër qytetet më të sigurta në Republikën e Kosovës. Këtë e dëshmojnë edhe faktet që nuk ka më tela gjemborë në asnjë cep të komunës, nuk ka tensione dhe probleme ndërtnike, kanë rënë në mënyrë drastike të gjitha llojet

e krimit. Kjo është arritur vetëm falë bashkëpunimit të mirë e të ngushtë të udhëheqjes komunale me qytetarë", ka thënë Bahtiri.

Në këtë takim Bahtiri ka thënë se është i zhgënjyer dhe i shqetësuar për moshapjen e urës mbi lumin Ibër. "Kjo gjë nuk duhej të ndodhte sepse është punuar shumë në këtë drejtim, për arsye se i kam besuar Bashkimit Evropian dhe z. Rakiqi, dhe në fund të procesit për hapje të urës ata ndryshuan qëndrimet e tyre

dhe kjo është shumë brengosëse për mua me vetë faktin se urat janë ato të cilat lidhin qytetet dhe mundësojnë lëvizjen e lirë të qytetarëve e kjo mos të ndodhë është jodemokratike dhe jonjerëzore. Andaj për këtë gjë unë kam marrë iniciativë që ta bashkoj qytetin e Mitrovicës sepse nuk dëshiroj që dikush të manipuloj me qytetarët e pjesës së veriut që ta ketë trupin në Mitrovicë e kokën në Beograd. Unë do t'u jap shërbime të gjithë qytetarëve

pavarësisht prej nacionalitetit në tërë territorin e Mitrovicës sepse roli im këtu është rritja e mirëqenies së qytetarëve të mi", ka thënë Bahtiri.

Ndërsa ambasadorja Pia Stjernvall i ka thënë Bahtirit se vazhdimisht ka qenë e interesuar për Mitrovicën, andaj edhe ka ardhur për të parë nga afër se si është gjendja, cilat janë vështirësitë me të cilat ballafaqoheni dhe çfarë është perspektiva për të ardhmen.

SHQIPTARËT NË BALLKAN



Ismet SYLEJMANI

Pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e kryengritjes gjithëpopullore të organizuar nga ajo më 1878!

Pas Kongresit të Alfabetit të Gjuhës Shqipe në Manastir më 1908!

Pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë më 1912!

Pas përfundimit të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare në Luftën e Dytë Botërore dhe epokën e sajë!

Lufta e ftohtë e Fuqive të Mëdha dhe pozita robëruese e popullit shqiptar nën ish - Jugosllavi, jo vetëm nuk e nënshtruan por as nuk e ndalën në përpjekjet e tij për liri e pavarësi!

Me gjithë vështirësitë e mëdha që ka pasur dhe vazhdon të ketë në rrugëtimin historik në shekullin e ri, në ecjen e tij progresive e me suksese të larta, për të cilat padyshim se në radhë të parë i është mirënjohës pafundësisht gjakut të derdhur për liri, luftës titanike dhe heroike të bijëve e bijave të tij më të mirë, për pozitën e re falenderon edhe miqtë dhe aleatet e mëdhenj, fitore e suksese këto që i tmerrojnë jo vetëm armiqtë dhe tradhëtarët, por e bëjnë edhe me madhështore ecjen

dhe fitoret e mëdha që po vijnë njëra pas tjetrës për Atdheun tonë të dashur e të shtrenjtë, i cili si kurrë më parë po vjen duke u ribërë e duke iu kthyer vetës me tërë shkëlqimin e fitimtarit dhe dalëzotësit të fatëve të veta në mijëvjeçarin e ri! Lufta e UÇK-së, bombardimet e NATO-s, lufta e UÇPMB-së, lufta e UÇK-së në Maqedoni, Pavarësia e 17 Shkurtit 2008-të e Kosovës dhe ngjarjet tjera që e shënojnë kalendarin e madh kombëtar të arritjeve të mëdha kolosale të Kosovës në njërin anë dhe të gjitha evenimentet tjera të vogla e të mëdha, kombëtare e ndërkombëtare, brenda Shqipërisë, te shqiptaret në Maqedoni, në Luginë të Preshevës dhe te shqiptarët në Mal të Zi, janë postulate të fuqishme për ecje të reja dhe fitore të mëdha në të ardhmen! Populli shqiptar, vazhdon të ngjitet në lartësitë e mëdha dhe të shënojë fitore të reja! Çështja shqiptare në ballkan jo vetem ka marrë drejtimit e duhura dhe që padyshim po shkon drejt zgjidhjes së drejtë e me peshë të re në arenën ndërkombëtare, por ajo po shihet qartë se do të shënoje suksese e momente të mëdha të fitoreve të reja, të cilat do të shtohen në vargun e sukseseve të cilat e bëjnë edhe më të begatë suksesin për të cilin ndonëse nuk është i përgaditur, populli shqiptarë do ta shijojë, sepse do të provojë në historinë e tij ngjitje të reja të arritjeve, që e bëjnë kombin me pozitë moderne e të padiskutueshme jo vetem në Ballkan dhe Europë, por edhe më gjerë!

Pozita e rëndë e trashëguar nga roberia 5 shekullore turke dhe një shekull roberi serbe, janë dy plagë që edhe pse jemi të lirë e të pavaruar, vazhdojnë të na kullojnë, të cilat na paraqesin shumë vështirësi, por që kemi arritur ti përballojmë me sukses

edhe në rrethana të reja! Brenda trojeve tona kemi aleatin e madh SHBA-në, e cila si kurrë më parë në historinë e kombit tonë, gjithnjë e më fuqishëm është duke mbështetur çështjen shqiptare në Ballkan!

Ditë të reja e të mëdha progresive po vijnë për shqiptarët në Ballkan!

Do të dijmë të ecim me zgjuarsiri e menquri, me suksese e fitore! E ardhmja është në anën tonë!

Prishtinë 12.12.2018!



Portret për piktoreshen e suksesshme Erlisa Çerkini

PRISHTINË, 13 DHJETOR (ER) - Erlisa B. Çerkini ka lindur në nëntor të vitit 2003. Që nga moshën katërvjeçare ka provuar fusha të ndryshme të artit, si baletin, pianon, por veten e ndien më së miri kur pikturon. Si natyrë e karakterizon modestia, butësia, vendosmëria dhe përkushtimi i madh në qëllimet që i vë vetes.

Në moshën dhjetëvjeçare prindërit e saj i bënë një dhuratë të pazakontë, me rastin e mbarimit të klasës së pestë me sukses të shkëlqyeshëm. E regjistruan në kurs vizatimi te studio "Da Vinci", e cila udhëhiqet nga piktori i zellshëm Faton Kryeziu. Kjo studio nxori në pah talentin e saj për pikturë që nga moshën dhjetëvjeçare. Pas një pune dhe përkushtimi për më shumë se tre vjet rresht, arriti që në nëntor të vitit 2017 në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës ta hapë ekspozitën e parë personale me rastin e ditëlindjes së katërbëdhjetë.

Paratë e pikturës së parë që shiti Erlisa ia dhuroi SOS Fshatit të Fëmijëve, po në ditëlindjen e saj, në nëntor të 2017-s. Erlisa është angazhuar edhe në aktivitete të ndryshme, si shah dhe gjimnastikë, me ç'rast ka fituar katër herë medalje (të argjendtë dhe të bronzitë) nga Federata e Gjimnastikës e Kosovës. Biografia e saj për moshën që ka është mjaft e pasur.



Erlisa në vitin 2015 ka marrë pjesë me një nga punimet e veta edhe në ekspozitën kolektive, të organizuar dhe mbajtur në Lugano të Zvicrës.

Në dhjetor të vitit 2017 është shpërblyer nga ambasadori anglez në Kosovë me mirënjohje për 'Qytetari aktive'. Po në muajin gusht të vitit 2018 është ftuar të marrë pjesë me ekspozitë personale në "Etno Fest", ku regjisori i njohur Fadil Hysaj e ka vlerësuar shumë lart talentin

e saj: "Kur i kam parë këto piktura nuk kam mundur të besoj se i ka bërë një vajzë 14-vjeçare. Erlisa, Zoti ta ka dhënë një talent që rrallë ia jep në 200 vjet dikujt, dorë gjeniale. Kjo vajzë ka me qenë krenaria jonë e ardhshme, e gjithë shekullit që vjen pas", është shprehur regjisori Fadil Hysaj.

Aktualisht Erlisa ka hapur ekspozitën e radhës në qendrën tregtare "Albi Mall", kati i III, të cilën e ka mbështetur Banka

"Raiffeisen". Erlisa ëndërron që në të ardhmen të mbajë ekspozita edhe në vende të tjera të botës. Përpos talentit të Erlisës, edhe motra e saj më e vogël, Stina ka pasion pianon, por edhe sportin e gjimnastikës. Në nëntor të këtij viti është organizuar gara nga Federata e Gjimnastikës së Kosovës, ku ajo është shpërblyer me medalje të argjendtë në disiplinën tra ekuilibri.

ARBEN DRESHAJ

ME FAT, KOSOVË, USHTRIA

*E bekuar qoftë kjo ditë
Shumë gjatë e kemi pritë
Me fat mandati i ri
FSK e jona Ushtria*

*Rri krenare e kokë lart
Je me plot fat e nder
Qe je pasardhëse e UÇK-së*

*Ushtrisë që lindi nga ky popull
Një luftë bëri, për një fitore
Një moto të thjeshtë kishte
Liri a vdekje në këto troje*

*Po dridhet toka, mali e fusha
Qielli po ushton
FSK po parakalon, kënga po jehon*


*"Jem sokola e sokolesha
Për këtë tokë s'na dhimbet jeta
Amanet na e la i pari
Komandanti Adem Jashari*

*Që nga jugu në veri
Trupat tona janë fuqi
Në çdo pëllëmbë e në çdo cep
Garantojmë sovranitet*

*Për sukses s'bëjmë kompromis
Për fitore jemi lind e rritë
Sytë shqiponjë na bëjnë dritë
Gjithë armiku na ka frikë*

*Me aleatë e për liri
Para nesh nuk ka kufij
Me shumë fat i kemi miqtë
Të pafat i kem armiqtë"*

*Me fat Kosovë Ushtria
Urime, qytetarë, aleatë e miq
Faleminderit nga zemra
E shenjtja Amerikë!*



E rrallë

Pema e Krishtlindjeve, e gjitha prej floriri

Kjo është pema e Krishtlindjeve më e shtrenjta në Evropë, me një vlerë 2.3 milionë eurosh. Pema është krijuar e gjitha me flori nga kompania gjermane "Pro Aurum", e cila merret me tregtinë e metalit të çmuar. Sipas kompanisë, pema mund të kushtojë më shumë në ditët në vazhdim, pasi vlera e arit është duke u rritur çdo ditë që kalon.



FOTO E DITES



Veturat lëvizin ngadalë përgjatë urës, në një trafik në Moskë të Rusisë. /AFP/

E jashtëzakonshme

Gjenden monedhat e arit, u fshehën për 900 vjet pranë pusit

Një koleksion me monedha të arit, të cilat besohet se u fshehën para 900 vjetëve, janë zbuluar nga arkeologët në qytetin e lashtë të Cezaresë, Izrael. Ata gjetën një kuti prej bronzi që përmbante monedha dhe një unazë të vetme ari. Të gjitha ishin të fshehura mes gurëve në anën e një pusi. Besohet se dikush fshehu kutinë me 24 monedha ari, por nuk u kthye ta merrte kurrë. Arkeologët thonë se pronari mund të ketë vdekur në vitin 1101.



BARSOLETA E DITËS



E pyeten një të moshuar se çfarë të këqijash ka pleqëria.
- Tri janë të këqijat e pleqërisë, tha i moshuari. E para është skleroza. Dy të tjerat i harrova.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

“ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

“NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

“SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

“VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**




DASHI

Mendimi juaj sot shkon te një person i caktuar që, mbase, nuk ka shumë probleme këtë periudhë, por gjithsesi është merakluar juaj i përhershëm.



DEMI

E dini që keni potenciale në vetvete, megjithatë në shumë raste nuk jeni në gjendje të dalloni kah anon e vërteta.



BINJAKËT

Sot provoni të vini si prioritare lumturinë tuaj. Në këtë mënyrë do t'i bëni të lumtur edhe ata që ju qëndrojnë pranë dhe që ju duan.



GAFORRJA

Në gjestet e vogla ju mund ta shihni dimensionin e vërtetë të njerëzve. Është mirë të vëzhgoni me vëmendje këtë gjë në të ardhmen.



LUANI

Duhet t'i jepni një shkundje të fortë situatës në të cilën ndodheni aktualisht. Jo gjithmonë duhet t'i lini gjërat në dorë të të tjerëve.



VI R G J Ë R E S H A

Duhet të jeni më praktik sot. Ka momente që nuk i keni parashikuar, por që mund ta prishin komplet rendin e ditës suaj.



PESHORJA

Ka disa çështje urgjente që nuk ju lënë të mendoni për më vonë. Duhet t'i zgjidhni sa më shpejt, pa hapur probleme të tjera që mund t'ju cenojnë.



AKREPI

Mendoni mirë kush janë gjërat e rëndësishme që doni të bëni sot. Nëse neglizhoni dikë nga pjesëtarët e familjes do të keni qejfmbetje më pas.



SHIGJETARI

Keni marrë të gjithë stresin e punës me vete në shtëpi sot. Askush nuk është i interesuar të dëgjojë për çështje pune kur do të qetësohet.



BRICJAPI

Keni lënë mundësi bashkëpunimi me të gjithë pa bërë dallime. Ka persona që në të shkuarën nuk ju kanë ndihmuar aspak që duhet t'i konsideroni.



UJORI

Edhe pse mënyra juaj e të vepruarit duket pak e ashpër sot, mos u shqetësoni. Vetëm kështu do të mund të merrni rezultate në fund të ditës.



PESHQIT

Sot do të keni përplasje takimesh me një mikun tuaj. Ju duhet të jeni në takimet që ai ka, por dhe ai duhet të jetë një mbështetje për ju.

Taylor Swift së shpejti do të fejohet



Taylor Swift është një ndër këngëtares që jetën private e mban shumë të fshehtë, ashtu e mbajti edhe lidhjen e saj me Joe Alwyn. Pas dy vjet lidhje, më në fund Joe ka vendosur të bëjë një hap të rëndësishëm për romancën e tyre,

sipas "Elle". Dëshira e Joes është që propozimi të jetë shumë i veçantë por, pavarësisht kësaj, është i sigurt se Taylor do t'i përgjigjet me "po". Çifti kohët e fundit është parë shumë së bashku dhe duket shumë i lumtur me njëri-tjetrin.

Gwen Stefani thotë se Blake Shelton është dashuria e saj e përjetshme



Gwen Stefani dhe Blake Shelton 'gjetën' dashurinë në vitin 2015. Qysh atëherë është përfolur vazhdimisht se ata do të fejohen derisa më vonë u raportua se Shelton do ta bëjë pyetjen e 'madhe' gjatë festës së Krishtlindjeve këtë vit. Por, duket se çifti nuk e ka këtë brengë. "Ka zero presion", ka thënë këngëtarja në një intervistë me Natalie Morales

për "Today". Këngëtarët e "You Make It Feel like Christmas" kanë filluar romancën e tyre pasi kishin gjetur mbështetjen e njëri-tjetri pas ndarjes nga bashkëshortët paraprakë. Stefani është pyetur nëse ylli 42-vjeçar i muzikës është "dashuria e përjetshme", ajo nuk ka hezituar të përgjigjet. "Shpresoj se po, është", ka thënë ajo me buzëqeshje.



Jennifer Lopezi shkëlqen në të bardha

Aktorja dhe këngëtarja e njohur Jennifer Lopez është një ndër emrat më të lakuara në media si për paraqitjen, po ashtu edhe për projektet dhe jetën private. Së fundmi ajo kishte mahnitur të gjithë me pamjen në

Manhattan, ku ishte e veshur e gjitha me të rroba të bardha. Jenniferi tashmë është e njohur për daljet e shpeshta në publik dhe për zgjedhjet e veshjeve ku asnjëherë nuk ndodh të mos duket bukur.

Zayn feston publikimin e albumit

Zayn Malik është fotografuar duke dalë nga ndërtesa e banesës së tij në Nju Jork, duke u drejtuar për tek ahengu i publikimit të albumit të tij. Këngëtari 25-vjeçar i shfaqti tatuazhet në gjoksën e tij me një këmishë të zeze të zbërthyer, xhakatë sportive dhe pantallona të stilit marinë, i shoqëruar nga anëtarët e familjes dhe një grupi miqsh. Pas përfundimit të ahengut, në rrjetin social në "Twitter" ai i ka falënderuar të gjithë që ishin të pranishëm për të festuar me të.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

SHEFF UTD - WEST BROM

1

LIVINGSTON - HEARTS

2

CELTA DE VIGO - LEGANES

1

Fetahaj shkëlqeu në vjeshtë, por nuk e di ku do të luajë në pranverë

Liridon Fetahaj ende nuk e di se ku do të luajë në sezonin pranveror, pasi për këtë do të vendosë klubi i Prishtinës dhe ai i Lirisë. "Unë kam kontratë me Prishtinën edhe një vit e gjysmë. Në sezonin vjeshtor isha i huazuar te Liria. Në pranverë nuk e di se ku do të luaj, pasi për këtë çështje janë duke biseduar kryesitë e klubeve", ka thënë Fetahaj

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Para fillimit të kampionatit 2018/2019, Liridon Fetahaj u huazua nga Prishtina te ish-skuadra e tij, Liria, për shkak se nuk kishte hapësirë e mjaftueshme në skuadrën kryeqytetase. Futbollisti Fetahaj rikthimin në ish-skuadër e shfrytëzoi për mrekulli për faktin se u shndërrua ndër lojtarët më të mirë në skuadrën prizrenase, madje hyri edhe në mesin e golashënuesve më të mirë në Superligë, me pesë gola të shënuara.

Pas përfundimit të sezonit vjeshtor Fetahaj nuk e di se cilën fanellë do ta djersijë në sezonin pranveror. Ai ka thënë për "Epokën e re" se kjo është një çështje që do të vendoset në mes të kryesisë së Klubit të Prishtinës dhe kryesisë së Lirisë, por nuk ka treguar se cila është dëshira e tij. "Unë kam kontratë me Prishtinën edhe një vit e gjysmë. Në sezonin vjeshtor isha i huazuar te Liria. Në pranverë nuk e di se ku do të luajë, pasi për këtë çështje janë duke biseduar kryesitë e klubeve", ka thënë Fetahaj.

Futbollisti anësor i Lirisë ka folur edhe për formën personale dhe atë të skuadrës gjatë sezonit vjeshtor. Pavarësisht se nuk është sulmues tipik dhe shënoi pesë gola, Fetahaj është i bindur se rezultatet kanë mundur të jenë edhe më të mira. "Nuk jam aq i



kënaqur me atë që kam treguar personalisht, pasi kam mundur të jap edhe më shumë. Ndërsa si klub kemi lëshuar shumë pikë që nuk është dashur t'i lëshojmë. Në disa raste jemi dëmtuar edhe nga gjyqtarët dhe, sikurse këto mos të ndodhin, do të ishim në vendin

e katërt", ka deklaruar Fetahaj. Skuadra e Lirisë e mbylli sezonin vjeshtor në pozitën e dhjetë me 19 pikë të grumbulluara, derisa regjistroi gjashtë fitore, një barazim dhe dhjetë humbje në shtatëmbëdhjetë ndeshjet e zhvilluara.

SHKURT

Ademi synon postin e nënkryetarit në Komitetit Olimpik

Agim Ademi, pasi e zëvendësoi legjendën Fadil Vokrri në postin e kryetarit të Federatës së Futbollit të Kosovës, po synon ta zëvendësojë edhe në postin e nënkryetarit të Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK). Kuvendi i punës së KOK-ut do të mbahet më 21 dhjetor. Përveç Ademit, kandidat tjetër është edhe kryetari i Federatës së Karatesë së Kosovës, Ismet Krasniqi.

Dy skitare do ta përfaqësojnë Kosovën në EYOF Sarajeva 2019

Ekipi Olimpik i Kosovës do të marrë pjesë për herë të dytë në Festivalin Olimpik Evropian Dimëror për të Rinj (EYOF), Sarajeva & Sarajeva Lindore 2019, që mbahet prej 9 deri më 16 shkurt në Sarajevë dhe Sarajevën Lindore të Bosnjë e Hercegovinës. Bordi Ekzekutiv i Komitetit Olimpik të Kosovës, në bashkëpunim me Federatën Skitare të Kosovës, ka vendosur që në EYOF Sarajeva & Sarajeva Lindore 2019 të dërgojë dy sportiste të skijimit alpin: Elba Kokaj dhe Klea Vrella. Të dy skitare, Kokaj (17-vjeçare) dhe Vrella (16), do të garojnë në disiplinat sllallom dhe sllallom i madh. Bashkë me sportistet do të udhëtojnë edhe trajnerët Feim Kollçaku dhe Egzon Agani. Kosova është në mesin e 48 shteteve të Evropës që do të marrë pjesë në EYOF Sarajeva & Sarajeva Lindore 2019. Për herë të parë në EYOF-in dimëror, KOK-u u paraqit në "Erzurum 2017".

Gjilani konfirmon largimin e Caesarit dhe Marinhos

Raportimin e gazetës "Epoka e re", se nga skuadra Gjilani janë larguar dy futbollistët e huaj, Mauricio Marinho dhe Trevin Ceasar, e ka konfirmuar vetë klubi nga Anamorava. "S. C. Gjilani në mirëkuptim të dyanshëm ka ndërprerë bashkëpunimin me dy futbollistët e ardhur në afatin kalimtar të verës. Bëhet fjalë për lojtarin Trevin Shonari Caesar i ardhur nga Trinidad dhe Tobago dhe për brazilianin Jose Mauricio Marinho të cilët kishin mbrojtur ngjyrat e klubit në pjesën vjeshtore të edicionit të sivjetmë në futbollin tonë. Gjilani i falënderon futbollistët për angazhimin sa ishin pjesë e klubit tonë dhe u uron sukses në vazhdimin e karrierës së tyre futbollistike", thuhet në njoftimin e Gjilani. Kjo skuadër ka konfirmuar se është në bisedime me disa futbollistë ku pritet të përfordhet në afatin kalimtar të janarit.

Drejtuesit e FFK-së takuan ish-presidentin e UEFA-s, Michel Platini

Prishtinë, 12 dhjetor - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi dhe sekretari i përgjithshëm, Eroll Salihu, kanë pasur një takim me presidentin e UEFA-s, Aleksander Čeferin, kurse ata e kanë takuar

në një takim joformal dhe miqësor ish-presidentin e UEFA-s, Michel Platini. Me këtë rast presidenti Ademi e ka falënderuar legjendën e futbollit francez për gjithçka çfarë bëri për futbollin e Kosovës dhe për hapjen e rrugës

së anëtarësimit në UEFA. "Platinit iu bë ftesë për të qenë mysafir i FFK-së si shenjë falënderimi për atë që bëri për futbollin e Kosovës të cilën ai e pranoi me kënaqësi", thuhet në njoftimin e FFK-së. Nga ana e tij,

Platini e kujtoi rrugëtimin e FFK-së për anëtarësim në UEFA dhe FIFA, derisa me nostalgji e kujtoi presidentin Fadil Vokrri dhe shprehi dhimbjen dhe ngushëllimet më të sinqerta për vdekjen e tij.



Dy derbi në Media Ligë, "Epoka e re" synon t'u rikthehet fitoreve

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Java e 14-t në Media Ligë sjell dy derbi, por edhe ndeshje të tjera të forta. Ekipi lider, "Epoka e re", pas humbjes nga "Gazeta Metro", pritet t'i rikthehet fitores në ndeshjen ndaj "D+", kurse

derbi i parë do të zhvillohet në mes të "Media Works"-it dhe "Gazetës Metro". Derbi tjetër zhvillohet në mes të ekipit të "Gazetës Zëri" dhe "Klan Kosovës". "Zëri" është në formë shumë të mirë, pasi ka regjistru-

ar tetë fitore radhazi, kurse "Klani" ishte ndër ekipet më të mirë, por me dy humbje radhazi i ka zbehur gjasat për pozitën e parë. Përballje të forta priten edhe në mes të "Infokusi"-it dhe "KosovaPress"-it si dhe në mes

të "RTV Dukagjini" dhe "Lajmi.net". Në përballjet e tjera takohen: "Ora Info" - "Kallxo.com", "InfoKosova & PrishtinaPost" - "Telegrafi", "RTV Dukagjini" - "Lajmi.net" dhe "Gazeta Blic" - "RTK".



Gashi: Suksesi i Istogut, dëshmi se kemi talente e cilësi në sport

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur të enjten në kabinetin e vet klubin e hendbollit në kategorinë e vajzave "Istogu", pas kualifikimit të tyre në mesin e 16 skuadrave më të mira të EHF Challenge Cup. Me këtë rast, ministri Gashi shprehu mirënjohje dhe falënderime për suksesin e radhës të hendbollisteve të klubit "Istogu", duke e vlerësuar kualifikimin e tyre në Challenge Cup si kualifikim historik. "Dua të përgëzoj këto sportiste të talentuara të cilat me punën e tyre tashmë kanë arritur të jenë pjesë e finales së Challenge Cup në mesin e 16 ekipeve më të mira të Evropës. Sukseset e sportistëve tona çdo ditë e më shumë po dëshmojnë se vendi ynë ka të rinj dhe të reja të talentuar që me punën e tyre po arrijnë suksese edhe jashtë vendit", ka thënë Gashi, i cili ka treguar se është i vendosur ta vazhdojë përkrahjen e sportistëve, sidomos krijimin e kushteve infrastruktur-



ore në mënyrë që ato t'i zhvillojnë aktivitetet e tyre në ambiente të përshtatshme sportive. "Ne jemi të përkushtuar që të punojmë për krijimin e kushteve për të gjithë sportistët e vendit dhe klubet tona që po vazhdojnë të korrin suksese edhe në gara ndërkombëtare. Andaj edhe sot ju bëj me dije se përkrahja jonë për vajzat e klubit

'Istogu' nuk do të mungoj", ka shtuar Gashi. Ndërkaq Faruk Shala, trajneri i klubit të hendbollit në kategorinë e vajzave "Istogu", falënderoi ministrin Gashi për pritjen e tij dhe për gatishmërinë e tij për të ndihmuar dhe përkrahur vajzat në rrugëtimin e tyre për arritjen e sukseseve të reja edhe jashtë vendit.

Toronto deklasoi kampionët e Golden States

Oakland, 13 dhjetor - Toronto fitoi 113-93 ndaj Golden States në fushën e këtij të fundit, sfidë që vuri përballë njëra-tjetrës dy skuadrat kryesuese të konferencave përkatëse. Por në fund triumfoi ekipi kanadez, ndjeshëm më superior në fushë, duke e udhëhequr gjatë gjithë kohës ndeshjen, me Lowry që ishte shënuesi më i mirë me 23 pikë e 12 asistime. Të gjithë titullarët e ekipit kanadez realizuan mbi 10 pikë, duke bërë diferencën në fushë (32 pikë u realizuan nga lojtarët e stolit), ndërsa për Golden States nuk mjaftuan 30 pikët e Durantit për ta evituar humbjen, me Warriorsin që zbrit në vendin e dytë në Perëndim. Pas kohës shtesë fiton ekipi i Bostonit, që mundi 130-125 Washingtonin jashtë fushës, ndeshje me rivalitet përgjatë gjithë kohës. Ndeshje e mirë për Irvingun, autor i 38 pikëve për Celticsin, mbështetur edhe nga Morrisin me 27 pikë, duke fituar duelin me Wallin (34 pikë). Humbet skuadra e Milwaukeees,



që këtë sezon ka bërë një paraqitje të mirë, duke qenë në vendin e dytë në Lindje. Milwaukee u mund 113-97 nga Indiana, sfidë ku vendësit patën gjatë gjithë kohës epërsi dhe triumfuan falë 25 pikëve e 11 reboundeve të Youngut si dhe 23 pikëve të Turnerit.

REZULTATET

Charlotte - Detroit	108-107
Cleveland - New York	113-106
Indiana - Milwaukee	113-97
Philadelphia - Brooklyn	124-127
Washington - Boston	125-130
Memphis - Portland	92-83
New Orleans - Oklahoma	118-114
Dallas - Atlanta	114-107
Utah Jazz - Miami	111-84
Sacramento - Minnesota	141-130
Golden State - Toronto	93-113

SHKURT

Realit rikthen interesimin për Icardin

Real Madridi ka ringjallur interesimin për kapitenin e Interit, Mauro Icardi, pasi klubi italian u eliminua nga Liga e Kampionëve. Interi që tani do të bëjë gara në Europa Ligë do të përballlet me interesimin e Realit për lojtarin më të mirë që së fundmi ka thënë se nuk do të largohet nga "San Siro" pa fituar ndonjë trofe me Interin. Gazeta "AS" raporton se largimi i hershëm i Interit nga "Championsi" mund t'ia ndryshojë mendjen Icardit dhe kjo do të jetë e mjaftueshme që Madridi ta tentojë transferimin e tij në janar, pas disa dështimeve gjatë verës. 25-vjeçari ka realizuar 12 gola në 18 paraqitje në të gjitha garat për Interin.

Wengeri: Zidane duhet të shkojë në Premierë Ligë

Ka kohë që Zinedine Zidane "dërgohet" në Premierë Ligë. Madje në stolin e Manchester Unitedit në vendin e Jose Mourinhos. Francezi është i papunë që pas dorëheqjes nga Realit i Madridit. Megjithatë, ai ka marrë një këshillë nga Arsene Wengeri. "Nëse ai do të punojë në majë të futbollit duhet të drejtojë në Angli ditët e sotme. Megjithatë, ka shumë pasiguri pas 'Brexit' dhe ngrihet dyshimi nëse Premierë Liga do të dominojë financiarisht. Anglia është vendi i vetëm ku 6 ekipe luftojnë për kampionatin. Në disa vende si Franca mund të thuash që në shtator se kush do ta fitojë titullin", ka thënë Wengeri. "Në rastin e tij unë do të shikoja një aspekt tjetër të punës. Ai është në një pozicion të vështirë, ka qenë në klubin më të madh në botë. Tani mund të shkojë te klubi i dytë më i madh në botë. Ai ose duhet të ndërtojë diçka nga fillimi me një projekt afatgjatë, ose të shkojë në një klub ku mund të konkurrojë menjëherë", ishin këshillat e Wengerit, i cili u tërhoq nga Arsenalit pas 22 vjetësh.

Toure rikthehet në Premierë Ligë

Mesfushori Yaya Toure është larguar nga Olimpiacos. Klubi grek ka konfirmuar se Toure po largohet si një mik dhe se dyert e kësaj skuadre gjithmonë do të jenë të hapura për të. Mediet në ishull raportojnë se ish-lojtari i Manchester Cityt, Barcelonës dhe Monacos po preferon rikthimin në Premierë Ligë.

Hazardi, objektiv i Bayernit

Bayern Munchen ka pasur gjithnjë si objektiv që të afrojë sa më shumë lojtarë nga kampionati gjerman, me synimin e vetëm për t'u forcuar vetë, por edhe për t'i dobësuar kundërshtarët. Kampionët e Gjermanisë kanë nisur të mendojnë që tani për lojtarët që mund të afrojnë. Synimi i radhës është lojtari i Gladbahut, Thorgan Hazard. Belgu ka bërë mjaft mirë këtë edicion duke shënuar dhe gjashtë gola. Lojtarit në fjalë i përfundon kontrata në vitin 2020 dhe Bayerni do të përfitojë nga kjo situatë.

Oweni: Pogba me Kloppin ose Guardiolen do të ishte ndryshe

Paul Pogba do të ishte një nga lojtarët më të mirë në botë nëse do të luante për skuadrat ku janë trajnerë Jurgen Klopp dhe Pep Guardiola. Kështu ka deklaruar ish-sulmuesi i Liverpoolit dhe Manchester United, Michael Owen. "Mendoj se trajneri duhet të marrë një pjesë të fajit, për sistemin dhe mënyrën se si ai luan. Më kujtohet kur Pogba nënshkroi së pari dhe po përpiqeshin me të gjitha llojet e mesfushorëve, brenda dhe përreth ekipit, që të merrnin më të mirën nga ai. Më vjen keq për të nga ky këndvështrim por, si lojtar, është frustruese kur e sheh Pogban. Ai ende duket sikur një 16 apo 17-vjeçar dhe po mëson lojën e futbollit. Mendoj se Pogba bën kaq shumë gabime në lojëra, gjë që është frustruese. Nëse ai do të luante siç duhet..., nëse do të luante nën drejtimin e Guardiolen, Kloppit apo dikujt tjetër si ata, mendoj se do të ishte një nga lojtarët më të mirë në botë. Por, për momentin nuk mund ta themi këtë", ka thënë Owen. "Pogba është krejtësisht lojtar i klasës botërore, por duke luajtur në një ekip të caktuar, në një mënyrë të caktuar. Jam shumë i irrituar ta shoh ashtu, sepse e di që është më i mirë se ai që e shohim javë pas javë. Nuk mendoj se mënyra se si skuadra po luan, ose mënyra se si trajneri po e menaxhon, është e favorshme për ta marrë më të mirën prej tij", ka deklaruar Owen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Administratës Publike
Ministarstvo Javne Uprave-Ministry of Public Administration

KONKURS

Në bazë të Nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Nenit 8 të Rregullores Nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Administratës Publike shpall konkurs për këtë vend pune:

Titulli i vendit të punës:

Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës (1).

Paga mujore: 1.171.17 € bruto.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Siguron këshilla të politikave për Ministrinë; siguron që vendimet e politikave dhe masat tjera të Ministrisë të zbatohen në mënyrë efektive dhe efektive; siguron që masat zbatuese të Ministrisë të monitorohen rregullisht dhe që të merren masa korrigjuese në rast të pengesave; menaxhon nëpunësit civil dhe punonjësit tjerë të Ministrisë; menaxhon financat dhe burimet e tjera të Ministrisë; menaxhon rrjedhën e informacionit në Ministrinë dhe koordinon raportet e Ministrisë me organet e tjera vartëse administrative etj.
- Përshkrimin e plotë të detyrave dhe përgjegjësi të punës për këtë pozitë mund të gjeni në linkun <http://map.rks-gov.net/getattachment/2c956b17-b2ba-459f-8131-c240e190cfe3.aspx>

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

- Në Shërbimin Civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar; janë në posedim të të drejtave civile dhe politike; kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimitin e funksioneve administrative, që sipas ligjit kërkohen për pozitën përkatëse.

Procedurat e konkurrimit:

- Konkurrimi për pozitën e Sekretar i Përgjithshëm është i hapur dhe kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë nëpunësit civilë në pozita të larta drejtuese, pozita drejtuese ose në pozita të barasvlershme në institucionet e administratës publike apo në kompanitë publike ose private.

Shkollimi i kërkuar:

- Diplomë universitare (minimum 4 vjeçare pas shkollës së mesme) apo të avancuar, e preferuar në fushat që ndërlidhen me punën e Ministrisë përkatëse.

Aftësitë, përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Duhet të kenë shkathtësi në përcaktimin dhe arritjen e objektivave strategjike të institucionit; aftësi të larta organizative dhe drejtuese; aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe negocimit; aftësi të dëshmuara për analizën e gjendjes dhe ofrimin e opsioneve; njohuri bazike në programet e kompjuterit; standarde të integritetit; ndershmërisë dhe drejtësisë.
- Së paku 8 vjet përvojë pune profesionale, përfshirë së paku 5 vjet në nivelin drejtues, pas diplomimit në universitet.
- Njohja e gjuhëve të huaja ka përparësi në rast të vlerësimit të barabartë të kandidatëve.
- Njohjen aplikantët se pjesë e vlerësimit të përzgjedhjes do të jenë kriteret e hollësishme të paraqitura në përshkrimin e vendit të punës.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

- Përzgjedhja e Sekretar të Përgjithshëm bëhet në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kohëzgjatja e emërimit:

- Mandati për pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm është 3 vjet.

Data e mbylljes së konkursit:

- Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit.

Paraqitja e kërkesave:

- Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Ministrinë e Administratës Publike, Zyra e Personelit, dhoma nr. 320, kati III , ndërtesa e Pallatit të Shtypit, Prishtinë, ose nëpërmjet adresës elektronike në linkun: <http://map.rks-gov.net>.
- Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, të diplomuarit në universitetet jashtë vendit t'ia bashkëngjisin dëshminë e nostrifikimit të diplomës; dëshminë për përvojën e punës; dëshminë se nuk është në hetim apo i dënuar për veprë penale (e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së këtij konkursi) dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës.
- Aplikuesit duhet të paraqesin: 1) një CV; dhe 2) një letër motivim me shpjegime të qarta dhe shembuj nga përvoja profesionale që tregojnë se si përvoja dhe aftësitë e tyre përputhen me kërkesat e vendit të punës.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë."

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e Shërbimit Civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3, të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës."

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.
- Në rast të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet t'i sjellin për verifikim dokumentet origjinale.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni znj. Sala Shala në tel: 038-20030620, prej orës 8:00 - 16:00.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Administratës Publike
Ministarstvo Javne Uprave-Ministry of Public Administration

KONKURS

Na osnovu člana 15 Zakona br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova i člana 8 Uredbe br. 06/2010 o Proceduri imenovanja u Visokim Upravnim Pozicijama u Civilnoj Službi Republike Kosova, Ministarstvo Javne Uprave objavljuje konkurs za sledeće radno mesto:

Naziv radnog mesta:

- Generalni Sekretar - Ministarstvo za infrastrukturu (1).

Mesečna Plata: 1.171.17 C bruto.

Zadaci i odgovornosti:

- Obezbeđuje političke savete Ministru; obezbeđuje da političke odluke i druge mere Ministarstva sprovedu efikasno i efektivno; obezbeđuje da mere sprovedenja Ministarstva se redovno nadgledaju i da se preduzimaju neophodne mere za prevazilažavanje prepreka; upravlja civilnom službom i ostalim zaposlenima Ministarstva; upravlja financije i ostale izvore Ministarstva; upravlja tokom informacija u Ministarstva i koordinira izveštaje Ministarstva sa ostalim nadležnim organima administracije itd.
- Kopmpletan opis radnih zadataka i odgovornosti za ovu poziciju možete naći na dole navedenom linku http://map.rks-gov.net/getattachment/911262db-0474-4480-859c-44d39fc38fa9/_.aspx

Uslovi učestvovanja regrutiranja su:

- U Civilnoj službi, imaju pravo da se zapošljavaju svi državljani Republike Kosova koji su odraslog doba i koji imaju punu sposobnost delovanja; koji poseduju civilna i politička prava; koji poseduju neohodno obrazovanje i stručnu spremu za obavljanje ekzekutivnih zadataka, upravljanja ili sprovođenja administrativnih funkcija i da imaju fizičku sposobnost, koje su neophodne prema zakonu za dotičnu poziciju.

Procedure konkursa:

- Konkurs za poziciju Generalni Sekretar je otvoren i pravo konkurisanja imaju civilni službenici koji su u visoko upravnim pozicijama, upravnim pozicijama ili pozicija koji su podjednaki u javnim ili privatnim kompanijama.

Zahtevano obrazovanje:

- Diploma univerziteta (minimum 4 godine nakon srednje škole) ili više, poželjna iz oblasti koja su nadovezana sa dotičnim poslovima Ministarstva.

Sposobnosti, iskustvo i ostala svojstva koja se zahtevaju :

- Potrebno je posedovati sposobnosti za određivanje i postizanje strateških objektivna institucije, kao i visoke sposobnosti organizovanja i upravljanja; odlične sposobnosti komuniciranja i sporazuma; dokazane sposobnosti za analiziranje stanja i predlog opcija; osnovno vladanje kompjuterskim programima; standarde integriteta, poštovanja i pravde.
- Najmanje 8 godine radnog iskustva u profesiji, uključujući najmanje 5 godina upravnog nivoa nakon diplomiranja.
- Poznavanje stranih jezika predstavlja prednost prilikom ravnopravnog vrednovanja kandidata.
- Obaveštavaju se aplikanti da će se vrednovanja bazirati na osnovu bližih detalja koji se nalaze u opisu radnog mesta.

Zakonski i podzakonski akti koji regulišu regrutiranje:

- Izbor Generalni Sekretar se vrši u skladu sa Zakonom br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova i Uredbe br. 06/2010 za Procedure Imenovanja u Visokim Upravnim Pozicijama Civilne Službe Republike Kosova i Uredbe br. 02/2010 za Procedure Regrutiranja u Civilnoj Službi.

Trajanje mandata :

- Mandat za poziciju Generalni Sekretar je 3 godine.

Datum zatvaranja konkursa:

- Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja.

Podnošenje zahteva:

- Aplikacije se uzimaju i dostavljaju u Ministarstvu Javne Uprave, kancelarija Personela, br. 320, III sprat, zgrada bivšeg Doma Štampe, Priština ili preko elektronske adrese kroz: <http://map.rks-gov.net>.
